





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, dt. 05/05/2023

02-341

Në mbështetje të nenit 8, 10, 11, dhe 15 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në nenin 8 dhe shtojcën 15 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Planin e Punës së MZHR-së për vitin 2023, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 1213 të dt. 15.08.2022 mbi Aprovimin e Udhëzuesit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për realizimin e Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2023, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
"Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimit publik në rrugën Ferizaj"

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Zhvillimit Rajonal e përfaqësuar nga Ministri i MZHR-së (në tekstin e mëtejme MZHR) dhe,
2. Komuna e Shtimes e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit **Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimit publik në rrugën Ferizaj** si dhe përcaktimi i obligimeve të MZHR-së dhe Komunës së Shtimes, për realizimin e këtij projekti.

Neni 2
Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti **"Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimit publik në rrugën Ferizaj"** ka vlerën paralogaritare prej 90,000.00 €.
2. MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2023, financon këtë projekt në shumën prej 50,000.00€.
3. Komuna e Shtimes nga buxheti i saj vjetor i vitit 2023, financon këtë projekt në shumën prej 40,000.00 €.

Neni 3
Obligimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

1. MZHR i zotën mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin "Rregullimi i shtigjeve të ecjes, çiklizmit dhe ndriçimit publik në rrugën Ferizaj" nga MZHR, do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, në rastin e bashkëfinancimit të projektit pagesat e para bëhen nga mjetet e zotuarat të buxhetit të MZHR-së.
3. MZHR monitoron këtë projekt në të gjitha fazat. Monitorimi bëhet përmes zyrtarit i cili caktohet nga kompetentët e MZHR-së ose nga OE që MZHR e kontraktën pa e përjashtuar edhe mundësin e monitorimit të përbashkët (Zyrtar i MZHR-së – OE) dhe në rast se vërejnë parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njoftojnë menaxhmentin.

Neni 4
Obligimet e Komunës

1. Komuna është e obliguar që pas pranimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe të protokolluar të hartoj projektin zbatues si dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim.
2. Komuna obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit, dhe një kopje ta dërgoj në MZHR.
3. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.
4. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, komuna duhet t'i filloj brenda 30 dite kalendarike pas nënshkrimit MiM në të kundërtën MZHR në mënyrë të një anshme mund të ndërpres marrëveshjen.
5. Komuna me rastin e formimit të Komisionit për procedurat e prokurimit dhe tenderimit duhet të kërkoj nga MZHR dy përfaqësues për procesin e hapjes së tenderëve (një anëtar kryesor dhe një anëtar zëvendësues) si dhe një përfaqësues nga MZHR si anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderëve. Anëtar i hapjes së tenderëve nga MZHR mund të jetë edhe anëtar i vlerësimit të tenderëve.
6. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MZHR së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).
7. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
8. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

9. Komuna obligohet që të njoftoj MZHR-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga MZHR (për pjesën e financuar nga MZHR).
10. Komuna duhet të vendosë tabelë informuese/Pano me dimensione rreth 2m X 1.5m në vend punishte me përshkrimin si në vijim:
 - a) Emri i projektit,
 - b) Investitorët (Ministria e Zhvillimit Rajonal me logon e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komuna),
 - c) Emri i operatorit ekonomik dhe
 - d) Kohëzgjatja e punimeve sipas Kontratës së nënshkruar në mes të Komunës dhe OE.
11. Komuna duhet të ndërmerret të gjitha masat që projekti të përfundojë gjatë vitit buxhetor 2023. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
12. Komuna është e obliguar të njoftoj MZHR -në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.
13. Komuna obligohet që pas përfundimit të projektit, obligimeve kontraktuale të dërgoj në MZHR dokumentacionin përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për t'i realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera deri në shumën e financimit nga ana e MZHR -së, të kompletoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
 - 1.2 Kopjen e deklaratës të disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit;
 - 1.3 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës;
 - 1.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet);
 - 1.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga MZHR;
 - 1.6 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
 - 1.7 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6
Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 7
Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MZHR-së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.
3. Në rastet kur paraqiten konteste të çfardo natyre përgjegjësia mbetet mbi Komunën, rrjedhimisht MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së kësaj Marrëveshje me automatizëm dhe mjetet e ndara për këtë projekt ti ndajë për kërkesat e Kategorisë së dytë - projekteve jashtë thirrjes për propozime.


Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët zgjedhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MZHR -së dhe Kryetari i Komunës.
2. Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Fikrim Damka
Ministër i MZHR -së



Qemajl Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimes

